

Politika e privatësisë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kjo politikë e privatësisë jep informacione të përgjithshme për përpunimin e të dhënave personale kur i vizitoni faqet tona të internetit www.sud.mk dhe <https://edostava.sud.mk> dhe / ose shfrytëzoni ndonjërin nga shërbimet tona përmes të njëjtave. I mbledhim vetëm ato të dhëna personale që janë të domosdoshme për t'i realizuar autorizimet dhe obligimet tona ligjore.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbrojtjen nga qasja e paautorizuar dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të shfrytëzuesve të vet dhe subjektet për të cilët rruan / përpunon të dhëna, i ndërmerret të gjitha masat e nevojshme organizuese dhe teknike, në bazë të rregullores ligjore dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

Kontrollor i përmbledhjeve së të dhënave personale

Kontrollor i përmbledhjeve së të dhënave personale është Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në bulevardin “Kërste Misirkov” nr.8, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Telefoni: 02 3 136 044
Faksi: 02 3 237 538
Posta - E: info@vsrm.mk

Të dhënat e kujt i mbledhim

- **Vizitorët në faqet tona të internetit www.sud.mk dhe <https://edostava.sud.mk>**
Zakonisht ne mbledhim të dhëna që përdoren për të ruajtur sigurinë e informacionit në faqet tona të internetit.
- **Shfrytëzuesit që bëjnë pyetje ose parashtrojnë parashtresa**
Këto pyetje / parashtresa përfshijnë informacione për identitetin e parashtruesit të kërkesës.
- **Shfrytëzuesit që kërkojnë qasje në informacionet me karakter publik**
Për përpunimin e kërkesave për qasje të lirë në informacionet me karakter publik kërkohet nga parashtruesit që të dorëzojnë të dhënat në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.
- **Shfrytëzuesit e shërbimit të Sistemit për dorëzim elektronik të dokumenteve gjyqësore me profil të shfrytëzuesit**
Për hapjen e profilit të shfrytëzuesit parashtruesi dorëzon të dhënat personale që janë të nevojshme për veprimin sipas autorizimeve ligjore të gjykatave.

Kategoritë e të dhënave që përpunohen

- Të dhënat e vizitave në faqet e internetit

Gjatë vizitës në faqet e internetit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për çdo qasje individuale të shfrytëzuesit krijohen shënime me logo që mund të përfshijnë informacione për:

- Datën dhe kohën e qasjes;
- IP (IP) adresë;
- Pajisja nga e cila qaset shfrytëzuesi, lloji dhe modeli;
- Sistemi operativ;
- Lloji i kërkesës;
- Faqet që shfrytëzuesi i viziton në faqet tona të internetit;
- Shteti (caktohet përmes IP adresës);

- Të dhënat që i dorëzojnë shfrytëzuesit vullnetarisht

- Shfrytëzuesit pa profilin e shfrytëzuesit - gjatë parashtrimit të pyetjeve, parashtrimin e parashtrësve ose kërkesën për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, shfrytëzuesit vullnetarisht i dorëzojnë të dhënat për identitetin e parashtruesit. Mund të mbledhim ndonjëherë nga këto kategori së të dhënave personale: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni dhe e-mail. Të njëjtat automatikisht dërgohen në e – majl adresën të personave zyrtar përgjegjës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përpunohen në pajtim me rregulloret ligjore.

- Shfrytëzuesit me profil të shfrytëzuesit – për këta shfrytëzues krahas detajeve teknike evidentohen edhe të dhënat e domosdoshme personale për krijimin e profilit. Për shfrytëzimin e shërbimit që e ofron Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut nevojitet identifikimi përkatës (konfirmimi i identitetit të shfrytëzuesit) dhe autorizimi përkatës (konstatimi i të drejtave – autorizimi për shfrytëzim).

Si i mbledhim të dhënat personale

Të dhënat personale i mbledhim përmes burimeve të ndryshme, duke përfshirë:

- Përmes formave për parashtrimin e pyetjeve, parashtrimin e parashtrësës, qasjen në informacionet me karakter publik dhe format për regjistrimin si shfrytëzues i Sistemit për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore me krijimin e profilit të shfrytëzuesit.
- Përmes kontakt e-mail adresave të arritshme të faqes së internetit
- Përmes postës
- Përmes faksit

E drejta për parashtrimin e kërkesës në AMDhP

Në qoftë se konstatojmë që mënyra me të cilën Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut i përpunon të dhënat Tuaja personale i shkel dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të parashtroni kërkesë drejtuar Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale si trup mbikëqyrës, për të cilën do të veprohet sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndryshimi i politikës së privatësisë

Politika e privatësisë do të ndryshohet dhe plotësohet rregullisht në përputhje me ndryshimet dhe aktivitetet tona.